



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2021:167963

Datë: 27.08.2024

Numri i dokumentit: 06091519

P.nr.30/2022

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Penal, gjyqtarja e vetme gjykuese Benita Berisha, me zyrtarin ligjor Besart Mustafa, në çështjen penale kundër të pandehurve: S.B., A.S.dhe A.S., për shkak të veprës penale Pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare nga neni 409 par. 1 e lidhur me nenin 31 të Kodit Nr.04/L-082 Penal të Republikës së Kosovës (tutje: KPRK), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, PP.II.nr.1533/2017 të datës 13.03.2018, jashtë seance, e në mbështetje të nenit 106 par.1 nën par 1.5, nenit 107 par.8 të KPRK-së dhe nenit 357 par.1 nën par.1.3 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (tutje: KPP), më datë 27.08.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

1. HEDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë PP.II.nr.1533/2017 të datës 13.03.2018 dhe PUSHOHET procedura penale kundër të pandehurve:

-S.B., me nofkën “....”, nga i ati M....., e ëma Xh....., e vajzërisë A....., i lindur me datë 20.02.1987 në fshatin, Mitrovicë, ku edhe jeton, i martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

-A.... S...., nga i ati A....., e ëma A....., e vajzërisë U....., i lindur me datë 27.08.1998 në fshatin K....., Mitrovicë, ku edhe jeton, i pamartuar, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal

- A.S., nga i ati A....., e ëma A....., e vajzërisë U....., i lindur me datë 24.12.1996 në fshatin K....., Mitrovicë, ku edhe jeton, i pa martuar, i pa punë, student, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, për veprën penale: Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare nga neni 409 par. 1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, për shkak të arritjes së parashkrimit absolut të ndjekjes penale.

2. Shpenzimet e procedurës penale mbulohen nga mjetet buxhetore të kësaj Gjykate.

3. Pala e dëmtuar, për realizimin e kërkesës pasurore – juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko – civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.1533/2017 të datës 13.03.2018, ndaj të pandehurve: S.B., A.S.dhe A.S., për shkak të veprës penale Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare nga neni 409 par. 1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Gjyqtarja e çështjes, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare përkritazi me afatin e parashkrimit, ka konstatuar se në këtë lëndë penale ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale për të pandehurit S.B., A.S. dhe A.S., sa i përket veprës penale të lartëcekur.

Sipas aktakuzës, të pandehurit janë akuzuar nën dyshimin se kanë kryer veprën penale: Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare nga neni 409 par. 1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së (ligj ky në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale) ku është përcaktuar dënimi me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se të pandehurit, veprën penale, dyshohet ta kenë kryer me datë 08.12.2017 dhe që nga ajo kohë (koha e kryerjes), e deri tani kanë kaluar më tepër se gjashtë (6) vite.

Në nenin 106, par.1, nën par 1.5 të KPRK-së, është përcaktuar se “*ndjekja penale nuk mund të ndërmerret kur të kenë kaluar tre (3) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se një (1) vit burgim*”. Ndërsa neni 107, par. 8, i të njëjtit Ligj, përcakton se “*ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit*”.

Rrjedhimisht, gjykata konstaton se nga kryerja e veprës penale e deri më tani ka kaluar më shumë se dyfishi i kohës që kërkohet për arritjen e parashkrimit çka do të thotë se ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale në bazë të nenit 107 par. 8 të KPRK-së, sepse brenda kësaj periudhe kohore nuk ka përfunduar ndjekja penale. Saktësisht, parashkrimi absolut i ndjekjes penale në këtë rast penal ka arritur me datë 08.12.2023.

Gjykata, konstaton se parashkrimi i ndjekjes penale është një fakt dhe rrethanë që në çdo rast sapo të vërtetohet se ekziston, Gjykata obligohet sipas ligjit ta hedh aktakuzën dhe pushoj procedurën penale. Ashtu që kjo Gjykatë, pasi ka vërtetuar se ndaj të pandehurve, ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale, për shkak të veprës penale Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare nga neni 409 par. 1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, e ka hedhur akuzën si dhe ka pushuar procedurën penale ndaj tyre.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale, gjykata e mbështetet në nenin 453 par. 1 të KPP-së.

Vendimin lidhur me kërkesën pasurore juridike, gjykata e mbështetet në nenin 462 par.1 dhe 2 të KPP-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit 357 par.1 nën par. 1.3 të KPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Penal
P.nr.30/2022, dt:27.08.2024

G j y q t a r j a
Benita Berisha

KËSHILLA JURIDIKE; Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa e personave të autorizuar në afatin prej 3 ditësh nga pranimi i tij, nëpërmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në kopje të mjaftueshme.